



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 3079 Prot.

Tiranë, më 15 . 03 . 2019

URDHËR

NR. 171 , DATË 15 . 03 . 2019

PËR

**RISHPALLJEN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, MËNYRËN E
VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË
DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të vendimit nr.782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë",

URDHËROJ:

1. Rishpalljen e procedurave të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të Vendimit nr.782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1 të njoftimit, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit do të jetë nga data 15.03.2019 - 26.03.2019.
4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e njoftimeve

zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të kualifikuar do publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, www.arsimi.gov.al.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Besa SHAHINI

